REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 335/20
Datë/Datum. 29.05.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	**KEK-20-235-5-1-1**
Nr i brendshëm	**KEKC-20-027-511**

Sa i përket tenderit për: **Optimizimi i kazantores ndihmëse**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

KCS TRADE L.L.C DPITS CRAS DOOEL:DPPU DMB production DOOEL

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Magjistralja Prishtine – Ferizaj, km VIII, Graçanicë, Llapnasellë

(Adresa)

Prishtinë — *(Vendi)*

10 500 — *(Kodi postar)*

049 718 817 — *(Numri Telefonit)*

N/A — *(Numri i Faks-it)*

Fadil Berisha

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@kcstrade-ks.com

(Adresa elektronike)

28.05.2020

(Data e parashtrimit të ankesës)

KCS TRADE Limited Liability Company • Magjistrala Prishtinë Ferizaj km 8

(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 10.02.2020 Data e hapjes së ofertave: 31.03.2020 Njoftimi mbi vendimin e AK: 14.05.2020 Kërkesa për rishqyrtim dt:19.05.2020 Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim dt:20.05.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Dosja është dorëzuar me ane te platformës elektronike te prokurimit, procesverbalin e hapjes e kemi pranuar nga ajo platforme.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] Jo [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] Jo [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 i LPP-së
Neni 56 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 41 i RRUOPP-së
Neni 44 i RRUOPP-së

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së me dt. 14.05.2020, ku jemi shpallur si tenderues i papërgjegjshëm, ndërsa është anuluar aktiviteti i prokurimit me arsyetimin se asnjë OE nuk është i përgjegjshëm konform kërkesave te FDT-së. Në këtë aktivitet të prokurimit kemi qenë vetëm ne ofertues dhe nuk ka ofertuar askush tjetër. Autoriteti kontraktues na ka eliminuar me arsyetimin se:

Tenderi juaj nuk është vlerësuar dhe me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak :
Sipas kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ku është kërkuar qe ofertuesi duhet: Te dorëzoj Autorizimin nga prodhuesi (OEM), nuk ka ofruar në oferte autorizimin e kërkuar nga prodhuesi i pajisjes që është e specifikuar ne specifikimin teknik te detyrueshëm, por ka ofruar vetëm autorizime nga prodhues ekuivalent, duke mos prezantuar asnjë autorizim apo marrëveshje teknike me të cilat dëshmohet se prodhuesit ekuivalent kanë me prodhuesin OEM – Bono Energia

Kjo arsye e eliminimit është e pabazuar sepse ne jemi OE i përgjegjshëm dhe përmbushim të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa ju sqarojmë se ne kemi ofruar autorizime për secilën pjesë që do të instalohet konform kërkesave të FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Në FDT kërkesë ka qenë pika 9.1 & 9.2 – Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale **"Autorizim nga prodhuesi (OEM)", pra** shihet qartë se arsyeja e AK-së për eliminimin tonë nuk qëndron pasi që autorizimi i lartpërmendur në arsyen e eliminimit tonë nuk është kërkuar të jetë ekskluzivisht nga prodhuesi i pajisjes që do të optimizohet pasi që nuk figuron askund emri "Bono Energia".

Sa për informimin tuaj, sqarojmë se termi apo shkurtesa OEM e përdorur tek kërkesa për autorizimin do të thotë **Original Equipment of Manufacturer,** që nëse e përkthejmë në shqip i bie **Prodhues Origjinal i Pjesëve** apo **Pajisje Origjinale të Prodhuesit.**
Pra është shumë e qartë se ne jemi eliminuar pa asnjë bazë ligjore, sepse askund nuk është precizuar nga ana e AK-së se Autorizimi i Prodhuesit duhet të jetë nga Bono Energia.

Duke pasur parasysh kërkesën e FDT-së dhe arsyen e eliminimit, rezulton se ne jemi eliminuar për një kërkesë e cila nuk ka qenë e precizuar në FDT dhe tek njoftimi për kontratë, prandaj ky veprim i autoritetit kontraktues bie në kundërshtim me dispozitat e nenit 56.3 të LPP-së, ku shkruan qartë: *''Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit''*.

Gjithashtu neni 7 i LPP-së, pika (v) parasheh qartë që *"që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies"*.

Ju sqarojmë se ne si operator ekonomik kemi dorëzuar Autorizimin e Prodhuesit për secilën pjesë që kemi paraparë të ndërrojmë gjatë optimizimit të kësaj pajisjeje (**kazantores ndihmëse),** ashtu siç është kërkuar në FDT dhe tek njoftimi për kontratë.

Ju informojmë se ky projekt siç edhe e dimë ka të bëjë me Optimizimin e kazantores ndihmëse dhe sistemi i punimeve ka qenë **turn-key** pra që nënkupton **me çelësa në dorë, ndërsa** as në FDT, e as tek njoftimi për kontratë nuk ka qenë e përcaktuar se cila pjesë duhet të përmirësohet apo cilat pjesë duhen të furnizohen. Për të gjithë ofertuesit potencial ka qenë i përgatitur dhe ofruar një **specifikim i performancës dhe funksional,** ku kuptohet qartë se AK-ja ka kërkuar nga OE të projektojnë vetë mënyrën e arritjes së performancës apo të arrijnë funksionalitetin e nevojshëm të kazantores. Në të tilla raste AK-ja nuk përcakton specifikim detal të asnjë pjese apo artikulli siç edhe ka vepruar në rastin tonë, mirëpo zgjidhja e asaj se çka duhet modifikuar, ndryshuar apo furnizuar mbetet në dorën e OE.

Kurdo që aplikohet ky lloj specifikimi është e nevojshme të informohen OE me gjendjen reale të pajisjes ekzistuese, llojin e saj, karakteristikat teknike si dhe niveli i performancës apo funksionalitetit të dëshiruar nga ana e AK-së. Andaj ju sqarojmë se autoriteti kontraktues ka dhënë shumë informata dhe tabela lidhur me gjendjen e kazantores dhe pajimet që ndodhen aty të cilat i ka prezantuar në aneksin 1.

Përpos kësaj gjithashtu ka organizuar edhe site-vizitë në vendin e ngjarjes për të parë për së afërmi secili OE se me çka ka të bëjë projekti.

Duke u bazuar në përshkrimet dhe informatat e dhëna nga AK-ja përmes sqarimit të ofruar tek Aneksi 1 si dhe në bazë të asaj që ne si OE kemi parë dhe na është thënë gjatë site-vizitës, kemi vërejtur se aty ka pajisje nga disa prodhues të ndryshëm, andaj eliminimi jonë nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se nuk e kemi sjellur autorizimin e prodhuesit nga Bono Energia është jo ligjor, diskriminues dhe tendencioz, sidomos kur dihet qartë se projekti është i tipit **turn-key. Gjithashtu** vlen të theksohet se kazantorja është prodhuar në vitin 2009 dhe tashmë është jashtë garancionit.

Kazantorja në fjalë me pajisjet e vendosura në të, sipas informatave tona të marra në site-vizitë nuk ka arritur asnjëherë performancën e nevojshme dhe të duhur ashtu siç ishte e paraparë më kërkesat inxhinierike të funksionimit për qëllimin e dedikuar dhe pikërisht për këtë arsye AK-ja ka kërkuar **Optimizimin** e saj e jo riparimin përmes ndërrimit të pjesëve.

Pra duke u bazuar në dispozitat e neneve të LPP-së dhe rregullave mbi specifikimeve teknike, kur kemi të bëjmë me Optimizim dhe projekte sipas sistemit **turn-key**, aplikohet lloji i specifikimi teknik funksional apo i performancës (*si në rastin konkret*) dhe se zgjedhja e asaj se çka do të instalohet është kompetencë dhe përgjegjësi e OE kuptohet që specifikimet duhet të jenë në përputhshmëri me pajisjen, andaj duke u bazuar në këto që u përmendën më lartë ne jemi OE i përgjegjshëm sepse i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Po ashtu edhe tek neni 2.1 i FTD-së-qëllimi i kontratës, qartë shkruan "**qëllimi i këtij projekti është aftësimi dhe optimizimi i kaldajës ndihmëse për prodhim të avullit te tejnxehur ne kapacitet maksimal dizajnues**".

Gjithashtu i njëjti përshkrim ishte dhënë edhe në gjuhën angleze tek aneksi 1 tek specifikimi teknik: 2. Purpose of this Project is to enable and optimize the auxiliary boiler for production of superheated steam at maximum design capacity.

AK-ja ka vendosur edhe kushtin që pjesët të jenë me kualitet të lartë, ndërsa për tu siguruar ka kërkuar edhe Autorizimin e Prodhuesit, ndërsa ne, për secilën pjesë që kemi projektuar e cila duhet të instalohet, kemi ofruar dokumentacionin e nevojshëm mbi kualitetin e tyre si dhe Autorizimin e Prodhuesit.

Më poshtë po ju bashkëngjisim disa nga autorizimet e ofruara nga ana jonë:

SAACKE

SAACKE GmbH | Postfach 21 02 61 | 28222 - Bremen | Germany

SAACKE International

SAACKE GmbH
Südwestallee 13
28237 Bremen
Germany

Material receipt
Rudolfstraße 68
28230 Bremen

Subject: Authorization

Date: 13.03.2020.

TO WHOM IT MAY CONCERN:

SAACKE GmbH hereby confirms that as of 27. February 2009,

CRAS
ul.Vasil Djorgov br.10
1400 Veles
MACEDONIA
represented by Mr.Ljupce Nedelkov

is an authorised distributor and service for our entire production program
for the territory of the Macedonia and Kosovo

Best regards,

SAACKE GmbH
i.A. Goran Stefic

SAACKE GmbH
Südwestallee 13
28237 Bremen - GERMANY

AUTHORIZATION LETTER

To Whom It May Concern,

We hereby confirm that the Company DPITS CRAS DOOEL located at:

Ul.Vasil Gjorgov br.10
1400, Veles
Macedonia

Is authorized to represent our company in bidding procedures and supply goods of MZT Pumpi AD to R. Kosovo for Tender Energy Corporation j.s.c - Procurement No. KEK-20-235-5-1-1.

All the goods supplied by DPITS CRAS DOOEL have manufacturer's warranties.

The authorization letter is valid till December 1st, 2021.

MZT PUMPI AD SKOPJE

МЗТ ПУМПИ АД СКОПЈЕ

Gjithashtu përpos këtyre autorizimeve ju mundeni në dosje të gjeni të gjithë dokumentacionin që ne kemi dorëzuar së bashku me tenderin tonë e ku vërehet dhe kuptohet se ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.
Përgjegjësia e optimizimit dhe funksionalizimit deri në arritjen e performancës së nevojshme, në rastet e tilla është e OE për çka edhe ofrohet garancioni i ekzekutimit t kontratës si dhe garancioni prej 24 muajve për punët dhe pajisjet e instaluara.

Gjithashtu vlen të theksohet fakti se pajisjet e vendosura tek kazantorja të prezantuara nga AK-ja në Aneks 1 të DT-së **nuk janë të gjitha nga prodhuesi Bono Energia**, prandaj në këtë mënyrë kuptohet lehtë dhe qartë synimi dhe veprimi i AK-së për të na eliminuar nga konkurrenca edhe pse nuk ka qenë si kriter i vendosur paraprakisht tek FDT- Dosja e Tenderit.

Ne me dt. 20.05.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje faktike dhe ligjore për refuzimin e kërkesë tonë për rishqyrtim.

Ndërsa sa i përket arsyes së refuzimit të kërkesës tonë për rishqyrtim AK-ja nuk ka dhënë asnjë dëshmi konkrete se ne si OE nuk i plotësojmë kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë por vetëm e ka cekur se ne nuk kemi ofruar prova të mjaftueshme me të cilat vërtetojmë se pretendimet tona janë të bazuara. Mirëpo ne edhe pse i kemi ofruar autorizimet përsëri nuk po merren parasysh nga ana e AK-së sepse me çdo kusht AK-ja po mundohet të na shpall si OE i papërgjegjshëm, duke na diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit, edhe

pse i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Përfundimisht autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së, duke na ka eliminuar pa bazë ligjore, pasi që oferta jonë është në përputhshmëri të plotë me të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 i LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi.

Duke u bazuar në të gjitha sqarimet që i kemi cekur më lartë, rezulton se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 44.5 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, sepse asnjëra nga kushtet e parashikuara në këto dispozita nuk janë përmbushur, për shkak se ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe natyrisht është dashur të shpallemi fitues i këtij tenderi.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar edhe dispozitat e nenit 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

V E N D I M

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **KCS TRADE L.L.C.**

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*